



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT/MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/MINISTRY OF
CULTURE, YOUTH AND SPORTS
AGJENCIA SHETETERORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS/DRZAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA/ STATE AGENCY OF
KOSOVO ARCHIVES

KONKURS PUBLIK PËR DIZAJNIMIN E LOGOS SË AGJENCISË SHETETERORE TË ARKIVAVE TË KOSOVËS

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës shpall konkurs publik për dizajnimin e Logos së institucionit - Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (AShAK), themeluar me vendimin Nr. 17000 të datës 20 mars 1951 nga Kuvendi i Kosovës.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës.

Kriteret e dizajnit të logos:

- Të jetë origjinale, unike dhe të mos jetë imitim i ndonjë logoje ekzistuese.
- Të ketë pasqyrim artistik të veprimtarisë së Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës;
- Të shpreh funksionin dhe mandatin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës;
- Të jetë e veçantë, kreative, kualitative, profesionale dhe prezantuese;
- Të jetë dinjitoze për identitetin e Institucionit përgjegjës për administrimin dhe ruajtjen e pasurisë arkivore në vend;
- Të jetë lehtësisht e kuptueshme;
- Të përçojë mesazh të qartë;
- Të jetë e dallueshme, t'i rezistojë kohës dhe të jetë e lehtë për tu mbajtur në mend;
- Të jetë e përshtatshme për vendosje në dokumente fizike dhe në paraqitje elektronike, e lehtë për shtyp, në sfonde të bardha dhe të errëta;
- Të jetë lehtë e përdorshme në madhësi të ndryshme;
- Të ketë shpjegim të secilit detaj të propozuar në logo

Mënyra e aplikimit:

Logoja duhet të dorëzohet në pliko të mbyllura me shifër dhe pa emër të autorit në CD, (në të kundërtën do të skualifikohet), bashkë me një version vektor të logos dhe po ashtu e shtypur në kopje fizike.

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë një manual të shpjegimeve të përmbajtjes dhe përdorimit. Aplikacioni duhet të ketë mbishkrimin "Për dizajnin ideor të Logos së ASHAK-së"
Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, Zyra e Prokurimit, Nr. 10
Adresa: Rr. „Arbnor e Astrit Dehari” nr.25 | 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë artistët nga Kosova, rajoni dhe bota.

Konkursi është i natyrës garuese dhe ideja më e mirë e përzgjedhur do të shpërblehet me 3,000€.

Të drejtat e autorit për propozimet e përzgjedhura barten nga propozuesi tek ASHAK.

Data e fundit e aplikimit është 15.8.2022.